

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	27.08.2018
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: 2607
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: 2607, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. të Prok: 616 18 73 421 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik 2607, të dt. 23.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. të Prok: 616 18 73 421, kundër **NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK** - të AK -së, të datës 15.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. 616-18-4389-2-2-3, Nr. Brendshëm 616 18 73 421 dhe mbështet NJOFTIMIN PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK - të AK -së, të datës 15.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 18.06.2018 ka bërë njoftimin për konkursin e projektimit lidhur me tenderin me titull: *"Konkurs projektimi për hartimin e projektit "Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit" Prishtinë"*, me Nr. 616-18-4389-2-2-3, Nr. Brendshëm 616 18 73 421.

Pranimi i ofertave të koduara nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 30.07.2018 Janë pranuar 3 oferta të koduara. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të pranimi të ofertave dhe vlerësimit të tyre.

Me datë 15.08.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë NJOFTIMIN PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK – të AK – së, të datës 15.08.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së, pas vlerësimit të projekteve ideore nga ana e Jurisë për ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 20.08.2018 në ora: 14:00pm Operatorit Ekonomik 2607, iu ka lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha projekteve lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik: 2607, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *"Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë"*, me Nr. të Prok: 616 18 73 421 , kundër Njoftimit për Konkursin e Projektimit të aktivitetit të prokurimit të AK –së, të datës 18.06.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 23.08.2018 sipas nenit 108/ A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

a) Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim) të Ligjit për Prokurimin Publik.

Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Pas shqyrtimit të konceptit që ka marrë pikët maksimale dhe krahasimin me kriteret vlerësuese të vendosura nga vet autoriteti kontraktues, shihet qartë që Juria ka anuar në vlerësimin e saj, duke dhënë kështu pikët maksimale për një projekt konceptual i cili nuk ka ofruar zgjidhjen e kërkuar.

b) Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të Ligjit për Prokurimin Publik.

4. Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsideroj një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Nëse i referohemi pikës 4 të këtij neni, atëherë shohim qartë që juria/komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar si duhet konceptin e të cilit i kanë dhënë pikët maksimale.

Shembull: Më poshtë janë kriteret për vlerësim të vendosura nga AK,

1. Kriteri Hapësinor (30), përfshinë:

Konceptin Hapësinor të zgjidhjes;

Raportin në mes të pjesëve dhe tërësive hapësinore;

Vlerat arkitektonike

Kualiteti i hapësirës

Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.

Ani pse AK ka kërkuar që nëpërmjet këtij konkursi të bëhet një analizë më e gjerë hapësinore, koncepti që ka fituar pikët maksimale nuk ofron një zgjidhje të tillë. Ai vetëm nëpërmjet një paraqitje grafike bënë prezantimin e situacionit të gjerë, por jo edhe trajtimit të zonës.

2. Kriteri Programor (3), përfshinë:

Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes;

Shfrytëzimi racional i hapësirës

Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor.

Pika e 5 e detyrës projektuese kërkon që në katin e parë të objektit të parashihen zyret administrative, duke e potencuar që ambienti të jetë sa me i hapur "Open Space".

Te koncepti me pikët maksimale, kjo gjë nuk vërehet, për më tepër hapësira (m2 per punëtor) e ndarë nuk plotëson normat/standardet që përmenden në literature.

Gjithashtu duhet potencuar që edhe organizimi i brendshëm i objektit nga ana e konceptit me pikët maksimale nuk përkon edhe me vet kërkesat e AK - së, që objekti të jetë inovativ, të ketë zgjidhje racionale (psh: vetëm zhvendosje e nyjeve sanitare të katit të parë mund të ketë kosto shtesë në renovimin e objektit dhe nevojë për ndërhyrje të reja në strukturë).

c) Pretendimi 3: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 80 (Përbërja e Jurisë)

1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.

2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.

Duke mos dashur t'i paragjykojmë anëtarët e jurisë (meqë kjo informate nuk na është dhënë nga AK), konsiderojmë që një juri e cila duhet të vlerësojë Objekte të rëndësishme veçantë, në këtë rast ndërtesa është në listën e monumenteve të mbrojtura, konsiderojmë dhe shpresojmë që të paktën dikush nga juria të ketë përvojë në këtë lëmi. Tek atëherë, vendimi i jurisë do të mbështetej në ligjet, rregulloret tona dhe rregulloret ndërkombëtare, në rastin e objekteve të tilla (UNESCO, Burra Charter, ICOMOS 1999 e të ngjashme).

Po ashtu në piken dy të këtij neni, përmendet që juria duhet të vlerësojë vetëm në kriteret e vendosura nga AK, të cilat ne mendojmë që i ka shkelur vet juria.

d) Pretendimi 4: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 57 - RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK - (Konkurs për Projektim - Kriteret e dhënies për projektimin ideor)

57. Konkurs për Projektim

Kriteret e dhënies për projektimin ideor

57.18 Kriteret e dhënies për projektimin ideor 57.18 Kriteret e dhënies që mund të përdoren për vlerësimin e projekteve ideore mund të përfshijnë: (i) inovacionin; (ii) përmbajtjen estetike; (iii) përshtatjen adekuate me mjedisin përreth; (iv) përdorimin efikas të hapësirës ekzistues; dhe (v) tërheqjen për përdoruesit potencial.

57.26 Juria do ta organizojë procesin e vlerësimit në atë mënyrë që të sigurohet integriteti dhe paanësia e procedurës. Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të kriterëve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit).

Për shkeljet e dispozitave të RRUOPP, ju lutem referojuni shkeljeve të perënduara me lart, në nenin 59 (në mënyrë që të mos përsëriten fjalitë e njëjta)

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e projekteve duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar me kodim.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar projektet në përputhje me LPP-ne.

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim) të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në përputhje me nenin 7 të LPP-se "Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim" par.2. dhe par.3 AK ka vepruar si në vijim:

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Autoriteti Kontraktues që prej inicimit të aktivitetit, pranimi të ofertave të koduara, formimit të komisionit të vlerësimit me anëtar profesional e deri të hapja e projekteve ideore për vlerësim dhe vlerësimi i projekteve (poentim) ka respektuar në tërësi nenin 7 të LPP-së.

b) Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) të Ligjit për Prokurimin Publik..

Ne përputhje me nenin 59, par.1 të LPP-së, dhe nenin 80, par.1 të LPP-se, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për krijimin e komisionit vlerësues profesional për vlerësimin e projektit ideor të ofertave të koduara siç është paraqitur si në vijim në këtë nen:

"1. Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyësor lidhur me këtë çështje.

80.1 Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të juriës duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.

KK Prishtina sqaron se Juria ka bërë vlerësimin e ofertave të koduara (projektit ideor) në bazë të kriterëve të cekura në dosje të tenderit siç janë:

Kriteri hapësinor (30), përfshinë:
Konceptin hapësinor të zgjidhjes
Raportin në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore
Vlerat arkitektonike
Kualiteti i hapësirës
Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.
30%

Kriteri programor (3), përfshinë:
Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes
Shfrytëzimi racional i hapësirës
Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe
programit hapësinor

30%

Kriteri ekonomik (20), përfshinë:

Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar

Racionaliteti i zgjidhjes

Mirëmbatja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e objektit 20%

Kriteri i komunikacionit (10), përfshinë:

Lëvizjet pa pengesa e automjeteve

Parkimi

Garazhimi 10%

Kriteri estetik dhe ekologjik / arkitektura e qëndrueshme (10), përfshinë:

Origjinaliteti i zgjidhjes

Inovacioni dhe vlera estetike

Zgjidhja konsekuente e tërësisë

Ruajtja dhe avansimi i hapësirës 10%

Ruajtja e gjelbrimit ekzistues

Eficienca energjetike

Anëtarët e Komisionit kanë dhënë vlerësimin e tyre me poentim siç janë:

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket totale
1.	4999	11.67
2.	2607	49
3.	1209	68.33

Anëtarët e Komisionit kanë dhënë edhe arsyeshmërinë e vlerësimit të poentuar siç ceket më poshtë:

Projekti me kod 4999, ka qene shume i mangët, si ne përmbushjen e kritereve ne përgjithësi, e gjithashtu i paqarte ne prezantim.

Projekti me kod 2607, ka pas disa mangësi.

Komisioni ka identifikuar dhe shqyrtuar këto si vërejtje:

Materializimi i parterit X

Organizimi i administratës X

Trajtimi i materialeve / konservimi X

Trajtimi i galerisë X

Trajtimi i stacionit te autobusëve X

Info point ide e qëlluar por jo mire e elaboruar, qasje vetëm nga rruga kryesore X

Si projekt bart disa pika interesante por shume mangësi me rëndësi kyçe për objektin.

Projekti me kod 1209

Qasja ne ndërtesë dhe korridor X

Te zhvendoset qasja për handikep X

Te eliminohet rampa ne hollin hyrës, si dhe te shqyrtohet zhvendosja e recepsionit, apo diskut pritës X

Si përfundim, ky komision vlerëson se te gjitha projektet nuk kanë elaboruar aspak kriterin e inovacionit dhe qasjes alternative moderne ne projekt, mirëpo projekti me kod 1209 ka dhënë projektin ideor më profesional dhe më të përshtatshmin në krahasim me dy ofertat tjera të koduara andaj edhe është vlerësuar dhe poentuar sipas parimit diskrecional - profesional në përputhje me parimin e ligjshmërisë që buron në nenin 59 të LPP-së.

c) Pretendimi 3: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 80 (Përbërja e Jurisë)

Autoriteti Kontraktues siç është cekur më lartë ka respektuar në tërësi nenin 80 të LPP-së me një juri profesionale për vlerësim të ofertave të koduara.

d) Pretendimi 4: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 57 - RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK - (Konkurs për Projektim - Kriteret e dhënies për projektimin ideor)

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e projekteve të koduara (projektit ideor) duke u bazuar në kriteret e dosjes së tenderit në pikën 23.1:

	Nën-kriteret	Pesha
1	Kriteri hapësinor (30), përfshinë: Konceptin hapësinor të zgjidhjes Raportin në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore Vlerat arkitektonike Kualiteti i hapësirës Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.	30
2	Kriteri programor (3), përfshinë: Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes	30

	Shfrytëzimi racional i hapësirës Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor	
3	Kriteri ekonomik (20), përfshinë: Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar Racionaliteti i zgjidhjes Mirëmbatja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e objektit	20
4	Kriteri i komunikacionit (10), përfshinë: Lëvizjet pa pengesa e automjeteve Parkimi Garazhimi	10
5	Kriteri estetik dhe ekologjik / arkitektura e qëndrueshme (10), përfshinë: Originaliteti i zgjidhjes Inovacioni dhe vlera estetike Zgjidhja konsekuente e tërësisë Ruajtja dhe avansimi i hapësirës Ruajtja e gjelbrimit ekzistues Eficienca energjetike.	10
Totali:		100

Vlerësimi i Anëtarëve të Komisionit për poentim ka qenë si në vijim:

	Nën-kriteret	Pesha	OE: 4999	OE: 2607	OE: 1209
1	Kriteri hapësinor (30), përfshinë: Konceptin hapësinor të zgjidhjes Raportin në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore Vlerat arkitektonike Kualiteti i hapësirës Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.	30	13	55	75
2	Kriteri programor (3), përfshinë: Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes Shfrytëzimi racional i hapësirës Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor	30	9	40	72
3	Kriteri ekonomik (20), përfshinë: Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar Racionaliteti i zgjidhjes Mirëmbatja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e objektit	20	5	25	28
4	Kriteri i komunikacionit (10), përfshinë: Lëvizjet pa pengesa e automjeteve Parkimi Garazhimi	10	5	15	15

5	Kriteri estetik dhe ekologjik / arkitektura e qëndrueshme (10), përfshinë: Originaliteti i zgjidhjes Inovacioni dhe vlera estetike Zgjidhja konsekuente e tërësisë Ruajtja dhe avansimi i hapësirës Ruajtja e gjelbrimit ekzistues Eficienca energjetike.	10	3	12	15
	Totali:	100	35:3 = 11.67	147:3= 49	205:3= 68.33

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe nën 80.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili nën përcakton "Asnjë person jashtë jurisë nuk mund të ndikojë ose të tentojë të ndikojë në vendimet e jurisë ose në opinionin e cilitdo nga anëtarët e jurisë, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.